

KËRKIME GJUHËSORE

Esmeralda STORRI

STUDIMI I TERMINOLOGJISË SË INFORMATIKËS DHE PASQYRIMI I SAJ NË GJUHË

Leksiku terminologjik i informatikës si sistem termash¹, është pasqyruar në një letërsi të gjerë shkencore, në doracakë, tekste mësimore. Në vitet e fundit termat e saj janë pasqyruar edhe në fjalorë të ndryshëm si në fjalorë filologjikë, dy a më shumë gjuhësh, si edhe në fjalorë terminologjikë. Kjo terminologji e re nuk është bërë objekt i studimeve të veçanta, por, megjithatë ajo ka tërhequr vëmendjen edhe të gjuhëtarëve terminologë dhe të specialistëve të fushës përkatëse. Në anën gjuhësore të saj po bëhen përpjekje për ta standardizuar atë, për ta sistemuar, por edhe për ta shqipëruar. Kjo vihet re ndonjëherë në nivelin e përdorimit të termave sinonimë si: *mi* - *miush* - *maus*, *folder* - *dosje*, *kibord* - *tastierë* - *tasturë* etj.

a. Pasqyrimi në tekste mësimore. Siç e përmendëm më lart kjo fushë e re po përfaqësohet edhe në tekste mësimore, disa koncepte elementare ku nxënësit njihen me zbatimin konkret të tyre (*kompjuter*, *maus*, *tastierë*) si edhe me termat përkatës. Kështu informatika ka filluar të futet dhe është futur si lëndë e veçantë mësimore, ku njohuritë janë në përshtatje me moshën e nxënësve. Në shkollë, kompjuteri, duke u lidhur me sistemin e internetit, po gjen një përdorim të gjerë për marrje njohurish në mënyrë jo të drejtpërdrejtë, për plotësimin e horizontit kulturor të nxënësve dhe të studentëve. Këtë literaturë që përmban njohuri teorike dhe praktike rreth informatikës mund ta grupojmë në:

a.1 Tekste të nivelit shkencor-popullor. Në këto tekste të këtij niveli jepen konceptet shkencore me terminologji të thjeshtë, ku në shumicën e rasteve përbëhen nga terma edhe fjalë të zakonshme si: *hap*, *mbyll*, *takoj*, *stakoj*, *klikoj*, *ruaj* etj. Në tekste të tilla termat në përgjithësi janë të thjeshtë dhe njëfjalësh, pra terminologjia nuk është e rënduar me togfjalësha kështu, p.sh., “*Një hap në botën e kompjuterit*”, lexuesit njihen me njohuritë bazë dhe me termat themelore të informatikës. Këto tekste destinohen për një masë të madhe njerëzish, dhe kryesisht shërbejnë për përdorimin praktik të kompjuterit.

a.2 Tekste të nivelit teorik. Tekste të tilla destinohen për një grup jo të madh njerëzish, kryesisht specialistë të fushës së informatikës. Padyshim terminologjia e tyre përbëhet nga një leksik i mirëfillt shkencor, i cili dallohet për njësi me struktura të përbëra; kështu togfjalëshat përbëjnë pjesën më të madhe të tyre si: *gjuhë e orientuar në procedura*, *gjuhë shenjuese deklarative*, *bufer kryesor i instruksionit*, *koprocesor grafik*, *oplikacion vertikal*, *formë parabolike*, *kontroll harduerik* etj.

Informatika si shkencë po përhapet dhe po gjen zbatim në shumë fusha dije. Madje ka kohë që është krijuar një degë studimi, e cila lidhet me fushën e gjuhësisë, e cila quhet *gjuhësi kompjuterike* ose *inxhinieri e gjuhës*. Në fushën e

¹ A. Duro, “Terminologjia si sistem”, Tiranë, 2001.

gjuhësisë kompjuterike janë krijuar edhe programe të veçanta për përpunimin e dukurive gjuhësore. Ajo kushtëzohet nga një terminologji e veçantë që lidhet me fushën e gjuhësisë, dhe që përmbajnë terma që lidhen me të si, *linguer, tagim (tagoj), lematizim (lematizoj), konkordancë etj.* Në bazë të konceptimit të kësaj fushe dije qëndron gjetja e elementeve të përbashkëta, universale, të pranishme në të gjitha gjuhët, të cilat shërbejnë për studimin e gjuhës, përkthimin me makinë, hartimin e fjalorëve elektronikë². Në universitet jepen njohuri speciale rreth kësaj disipline, e cila zhvillohet edhe si lëndë mësimore: “*Hyrje në gjuhësinë e informatikës*” (K. Lagji). Si lëndë speciale informatika zhvillohet në degën e informatikës, në **Fakultetin e Shkencave të Natyrës**. Në ditët e sotme zbatimi i njohurive të informatikës bëhet edhe mbi baza institucionale. Kështu, ka ekzistuar për vite me radhë Qendra e Informatikës si: **INIMA** (sot integruar në UT). Po kështu ekzistojnë **Instituti i Statistikës, InfoSoft etj.** Vlen të nënvizohet se shumë terma të informatikës që sot përdoren në këtë fushë, janë përdorur më parë në fusha të tjera të dijes si në elektronikë, elektroteknikë, gjuhësi, fizikë, por shumica e tyre jo në kuptimin që kanë sot në informatikë si: *informacion, sasi informacioni, komunikim, transmetim*. Në kohën e sotme ato përbëjnë edhe termat themelorë të Informatikës si shkencë dhe si teknologji.

b. Pasqyrimi në fjalorë.

b.1 Fjalorë shpjegues të gjuhës. Shkalla e pasqyritit të termave të informatikës në fjalorët shpjegues të shqipes (duke filluar qysh nga paprania e tyre në ta dhe deri te përfaqësimi në masë të kufizuar) është kushtëzuar nga shkalla e zhvillimit të informatikës në vendin tonë si teori, teknologji dhe veprimtari praktike. Kështu, p.sh, në “*Fjalorin e gjuhës*” (1954) nuk takohet ndonjë term i mirëfilltë i degës në fjalë. Kjo dëshmon se kjo fushë dije është futur në vendin tonë në një fazë të mëvonshme të zhvillimit të saj, në krahasim me vendet e tjera të zhvilluara të botës si në SHBA, Angli, Francë, Itali etj. E njëjta gjë thuajse vihet re edhe në “*Fjalorin e shqipes së sotme*” (1980). Ndonëse në të rrallë mund të takohen fjalë a terma që janë vënë më vonë në bazë të shkencës së informatikës si: *shtyp, afishoj, informim, format, automatizim, automatik*. Në këtë fjalor, këta terma nuk shpjegohen në kuptimin e posaçëm të informatikës, por në kuadrin e fushave të tjera të teknikës a të një fushe tjetër. Informatika si fushë dije nuk ekziston si shkurtime (inf.) sikurse fushat e tjera (tek, mek) që shërbejnë në fjalorë për të treguar përkatësinë e fjalës a termit në fushën përkatëse të dijes.

Për herë të parë termat e informatikës, ndonëse në një sasi shumë të vogël, janë përfshirë në “*Fjalorin e shqipes së sotme*” (2002) dhe pak më gjerë në “*Fjalorin e gjuhës shqipe*” (2006). Në mënyrë të veçantë në “*Fjalorin e gjuhës shqipe*” (2006) nga e gjithë sasia e fjalëve që përfshihen në të aty takohen edhe terma të fushave të ndryshme. Nga rreth 70 fusha të ndryshme, kanë mundur të gjejnë vend fjalët terma nga dega e informatikës që tashmë janë bërë pjesë përbërëse e shqipes së sotme, të folur e të shkruar si: *disketë, formatoje e formatim*,

² A. Duro, “Terminologjia në ligjërimin e specializuar”, “Studime filologjike”, 1997 / 1-4.

STUDIMI I TERMINOLOGJISË SË INFORMATIKËS DHE PASQYRIMI I SAJ NË GJUHË

internet, klikoj e klikim, kompjuter, kompjuterik e kompjuterizoj, mi (miush), kursor, mikroprocesor, printer, printoj, printim, i printuar, monitor, monitoroj, monitorim, laser e laserik, skaner, skanoj, skanim, kompaktdisk e ndonjë tjetër.

Megjithatë përkufizimi për disa fjalë të dhëna në këtë fjalor do të mund të jepej edhe për fjalë, ndonëse të njohura, por me kuptimet që kanë në fushën e informatikës. Këtu para së gjithash, mendojmë për fjalët që i përdor secili përdorues i kompjuterit, që mund të jenë të reja ose shumica të huazuara nga gjuha e përgjithshme ose nga fusha të tjera të dijës si: *disk, dritare, dosje, ikonë, skedar, kujtesë, ruaj, virus, tast, tastierë*. Aty duhet të gjenin vend edhe fjalët terma të informatikës, të përdorimit të përgjithshëm, ose të krijuara brendapërbrenda shqipes, si: *faqeshenjues* (për *bookmark* të anglishtes), *fjalëkalim* (për *passuord*), *fletëmbajtje* (për *clipboard*), *shkurtore* (*shortcut*), *regjistresë* (për *record*) e ndonjë tjetër. Kjo do të ndihmojë futjen në përdorim të termave të informatikës dhe do të përshpejtojë procesin e normëzimit e të standardizimit të tyre.

b.2 Fjalorë terminologjikë dhe dygjuhësh. Standardizimi i terminologjisë, ka si objektiv njësimin dhe harmonizimin e koncepteve, të sistemeve të termave e të përkufizimeve si edhe standardizimin e terminologjisë në tërësi. Kjo duhet pasqyruar sidomos në një fjalor terminologjik normativ, në të cilin çdo koncept duhet të ketë një term si shënues të vetëm të tij. E njëjta gjë duhet thënë edhe për terminologjinë e informatikës. Ky fakt duhet theksuar në mënyrë të veçantë edhe për terminologjinë në fjalë, meqë shumëkuptimësia e termave krijon vështirësi në të kuptuarit e përpiktë të domethënies së tyre, në komunikimin ndërmjet njerëzve në përgjithësi e madje edhe ndërmjet vetë specialistëve të një fushe. Termat duhet të jenë kështu të njëkuptimshëm. Parimi i njëkuptimësisë është një ndër parimet themelore të terminologjisë, që duhet zbatuar në këtë fushë.

Në fjalorët terminologjikë të informatikës përveç termave të mirëfilltë të informatikës, përfshihen edhe një numër i madh termash nga fusha të tjera si nga akustika, elektronika, fizika, gjuhësia, logjika, telekomunikacioni etj, për arsye se ata shpesh hasen në literaturën nga fusha e informatikës. Fjalorë të këtyllë në të shumtën e rasteve vetëm i japin me barasvlerësit përkatës në gjuhë të tjera dhe më rrallë i përshkruajnë (përkufizojnë) ata që përdoren në fushën e informatikës dhe në fushat me të cilat ajo lidhet.

Nga ana tjetër, në shumë fjalorë terminologjikë të fushave të tjera të dijës, si edhe në fjalorë të përgjithshëm dygjuhësh, përfshihen terma nga informatika. Një fjalor i tillë është "*Fjalori anglisht-shqip i radioelektronikës*". Fusha e informatikës në këtë fjalor përfaqësohet me dy nënfusha: "*kompjuterët, ordinatorët*" dhe "*teknika llogaritëse elektronike*". Sipas autorit, 75% e termave në anglisht janë dhënë me barasvlerësit e tyre në shqip, ndërsa pjesa tjetër, prej 25% është dhënë me parafrazime si: *clock* jepet për: *burim kryesor i sinjaleve të sinkronizimit në ordinatorët elektronikë*, apo për termin *laptop* jepet: *lloj kompjuteri me përmasa të vogla*. Shihet se autori nuk ka synim normëzimin e termave, por në radhë të parë, përkthimin e shpjegimin e tyre.

Në fjalorët terminologjikë dygjuhësh a disagjuhësh do të duhej të jepeshin barasvlerësit shqip të termit në gjuhë të huaj, nëse jo me karakter normëzues-standardizues, por së paku me sugjerim të hierarkisë së rekomanduar apo të parapëlqyer të përdorimit të termave. Kështu bie fjala, për termin *computer* të anglishtes, nëse nuk jepet vetëm *kompjuter*, term ky që propozohet të ngrihet në normë, atëherë do të duhej dhënë: *kompjuter*, *makinë llogaritëse*, *ordinator*. Në fjalorin në fjalë kjo renditje është e përkundërt: *computer* – *ordinator* - *pajisje elektronike që shërben për dhe përpunimin e informacionit*, *makinë llogaritëse elektronike*, *kompjuter*. Termi *kompjuter* si temë fjalëformuese në këtë fjalor haset vetëm në elementet të çerdhes fjalëformuese: *computerize* - *kompjuterizoj* dhe *computerized* - *i kompjuterizuar*, *i pajisur me makinë llogaritëse*. Të gjithë termat e tjerë që në bazë kanë fjalën *computer* të anglishtes jepen me termin *ordinator* ose me termin *makinë llogaritëse elektronike*. Kështu kemi, për shembull, *computer - based*: *i bazuar në përdorimin e ordinatorit*; *computer - operation*: *operacion ordinatori*, *operacion i makinës llogaritëse*.

Një fjalor tjetër tregjuhësh, në të cilin takohen aty-këtu terma nga informatika dhe pikërisht nga interneti është “*Fjalori enciklopedik anglisht-italisht-shqip për bankën, biznesin, bursën, ekonominë, ...internetin...*” (2001)³. Nga termat e informatikës që jepen në këtë fjalor, po veçojmë njësitë që lidhen me kompjuterin e që kryesisht janë shqipëruar, si: *computer* - *kompjuter*, *mjet llogaritës*; *computer* - *console* - *panel kompjuteri*; *computer integrated manufacturing* - *fabrikim i kompjuterizuar*; *compjuter tape* - *shirit kompjuteri* etj. Termi *personal computer* jepet: - *kompjuter stacionor*, ndërsa termi *laptop* - *kompjuter lëvizës*.

Që një pjesë e fjalorit të informatikës është bërë pjesë përbërëse e leksikut të përgjithshëm, dëshmon edhe “*Fjalori anglisht-shqip*” i Ramadan Hysës. Në të hasim terma të informatikës, duke filluar nga termi *computer*, i cili së bashku me fjalët e prejardhura nga ai ose të ndërtuara me të, i jep një çerdhe prej 15 termash togfjalësha: *computer* - *makinë llogaritëse*; *kompjuter*, *ordinator*, *computer dating* - *takim (dy personash) me ndihmën e sistemit informatik telefonik* etj. Siç mund të vërehet edhe te ky fjalor për fjalën - term *computer* të anglishtes kemi po të njëjtit barasvlerës si te fjalori i Tomçinit, vetëm me renditje tjetër. Më së fundmi është botuar dhe një fjalor i mirëfilltë i informatikës dygjuhësh nga Akademia e Shkencave dhe e Arteve të Kosovës⁴. Ky fjalor përmban rreth 5000 terma dhe shkurtesa, anglisht-shqip e shqip-anglisht nga fusha e informatikës. Një fjalor i tillë është shumë i vlefshëm jo vetëm për një masë të kufizuar njerëzish (specialistë të fushave të caktuara), por për një masë më të madhe njerëzish. Duke qenë se është një fjalor dygjuhësh, ai është destinuar për një rreth më të madh përdoruesish, domethënë jo vetëm për specialistë.

³ Fjalori enciklopedik anglisht-italisht-shqip për bankën, biznesin, bursën, ekonominë, ...internetin.... (2001).

⁴ Caka, N. Dika, A. Rodiqi, S. “Fjalor i informatikës” (anglisht-shqip, shqip-anglisht), Prishtinë, 2005.

STUDIMI I TERMINOLOGJISË SË INFORMATIKËS DHE PASQYRIMI I SAJ NË GJUHË

Nga kjo pikëpamje fjalori mund të vështrohej në rrafshin e dy gjuhëve. Ky fjalor përmban terma të një mase të gjerë e gjithëpërfshirëse të fushës në fjalë, por është për t'u vërejtur se në to ka shumë terma që s'i përkasin fushës së informatikës edhe pse këto fusha (matematikë, fizikë, logjikë, gjuhësi) janë të lidhura ngushtë me informatikën. Disa terma duken të panevojshëm për t'u përfshirë në të, si p.sh. *aksiomë, fosfor, impuls, sinus, fraksion etj.* Po ashtu e njëjta gjë vlen për disa njësi të tjera që s'kanë të bëjnë me terminologjinë e fushës së informatikës si p.sh. *aktiv, absolut, i vogël, i ndritshëm, i lëvizshëm, lart, majtas, negative, neutral, i ngjeshur, i përgjithshëm.* Këto fjalë – terma dhe fjalë të zakonshme janë të motivuara për t'u përfshirë në fjalor në përbërje të togfjalëshave.

Një anë tjetër që vlen të vështrohet në mënyrë të veçantë është problemi i standardizimit të terminologjisë në fjalë. Kështu, aty bie në sy përfaqësimi i tepruar i sinonimisë si: *aplikacion - zbatim, frekuencë - denduri, konektor - lidhëzor, ndërfaqe-interfejs, adapter - përshtatës, përdorues - shfrytëzues, shkarkoj - zhbart, android - sinjeri, kontrast - kundërshti, ngjeshje - kompresion etj.* Megjithëkëtë, siç e përmendëm më lart fjalori ka vlera të pazëvendësueshme si për sistemin e terminologjisë në fjalë, ashtu edhe për standartizimin dhe shqipërimin e saj. Aty gjejmë të shqipëruar një varg termash të anglishtes si: *adapter (përshtatës), android (sinjeri), konektor (lidhëzor) etj.*

Dukuri të funksionimit dhe të sistemit. Terma dhe paraqitja e tyre.

Veçoritë e terminologjisë së informatikës kushtëzohen edhe me shkallën e zhvillimit të saj, si terminologji e re ende e pakristalizuar dhe e paformësuar përfundimisht. Duke theksuar se, ndërsa niveli i zhvillimit të koncepteve të saj lidhet me zhvillimit të informatikës si fushë dije pak a shumë e konsoliduar, niveli i zhvillimit të termave mban vulën e aftësisë ose paaftësisë relative të gjuhës për t'i shprehur konceptet përkatëse. Në lidhje me shkencën e informatikës dhe terminologjisë së saj, numri i koncepteve është relativisht i madh dhe ato janë futur në gjuhën shqipe në mënyrë kaq të menjëhershme, saqë gjuha s'mund t'i përgjigjet plotësisht me mjetet e saj. Prandaj një pjesë konceptesh hyjnë së bashku me termat nga gjuha e huaj (angleze) dhe një pjesë e tyre përshtaten, kurse një pjesë shqipërohen etj. Në disa raste lëkundjet arrijnë deri aty sa një term herë paraqitet në shqipe si shkruhet *hardware, software* herë siç shqiptohet *harduer, softuer*. Shumica e termave të informatikës janë të huaj e kryesisht të huazuar nga anglishtja. Arsyeja është e thjeshtë: pajisjet e ndryshme kompjuterike dhe programet e shumta të tij vijnë nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe nga vende të tjera të industrializuara. Për shkak të pamundësisë së reagimit të shpejtë dhe me sukses për krijimin e një terminologjie të njësuar të informatikës, dashje pa dashje shpesh përqafohet termi i anglishtes, madje pa përshtatjen e nevojshme fonetike, morfologjike e semantike. Anglishtja, falë globalizimit dhe internetit, po merr rolin e gjuhës ndërkombëtare të së ashtuquajturës gjuhë botërore. Kështu edhe *kompjuter* edhe *harduer* e *softuer* edhe *internet* e *ueb* po bëhen terma me shtrirje ndërkombëtare. Pra, këta terma paraqesin një problematikë të kësaj

terminologjie dhe aq më tepër vështirësi në komunikim të një grupi jo pak të vogël njerëzish. Dhe si kriter përcaktues mendojmë që këta terma të shkruhen ashtu siç shqiptohen dhe t'i nënshtrohen eptimit të shqipes sipas drejtshkrimit tonë. P.sh *fajl* për *file*, *harduer* për *hardware*, *imejl* për *e-mail*, *RAM-I* për *RAM*, *ueb* për *web*, *uërd* për *word*, *meny* për *menu* etj, ndonëse në korrespondenca (adresime) ato duhen dhënë në variantin e shkruar si: *Web*, *e-mail* etj.

Problem të veçantë përbëjnë fjalët e zakonshme që përdoren krahas termave, por që janë pjesë e programeve. Si të tilla janë fjalë që shënojnë instruksione, mënyra veprimesh etj si: *read*, *end*, *begin*, *for then*, *record*, *close* edhe që dalin të tilla në kompjuter. Ky është një problem i veçantë dhe nuk mund të zgjidhet në kuadrin e terminologjisë (sepse këto njësi janë fjalë dhe jo terma). Megjithatë ato mund të kenë vend në një fjalor terminologjik dhe mund të jepen si inventar leksikor i informatikës me përkthimin përkatës si: *read* - *lexoj*, *end* - *fund*, *for* - *për* (në vend të), *then* - *pastaj* etj. Përsa i përket fjalëve të përdorura si terma, si kriter, siç u tha edhe më sipër duhet të jetë shqiptimi si *fajl* (e jo *file*), *harduer* (e jo e *hardware*), *softuer* (e jo *software*) etj.

4.b. Dukuritë semantike. Mungesa e një terminologjie të njësuar pa mëdyshje e vështirëson përdorimin e efektshëm të pajisjeve dhe të programeve kompjuterike nga ana e vetë specialistëve, por edhe përdoruesve të zakonshëm. Kështu që, krijohet një situatë dyformëshe, si p.sh ka përdorime që mund të interpretohen: *kompjuter* - *ordinator* - *makinë llogaritëse* - *makinë elektronike llogaritëse* - *pajisje elektronike që shërben për ruajtjen dhe përpunimin e informacionit* - *mjet llogaritës*; *monitor* - *displej* - *ekran*; *fajl* - *fushë* - *skedë*; *dosje* - *folder*. Kështu që del edhe nevoja e ngutshme për standardizimin e terminologjisë së informatikës, së paku të asaj pjese që tashmë ka hyrë në përdorim të gjerë, jo vetëm profesional, por edhe të përgjithshëm. Një tjetër dukuri që vihet re në këtë terminologji është shumëkuptimësia e termave, e cila krijon vështirësi në të kuptuarit e saktë të domethënies së termave, siç vihet re në njësitë e dykuptimshme: *displej*, *çelës*, *karakter*, *font*, *lak*, *unazë* etj. Vetë termi *kompjuterizoj* është i shumëkuptimshëm: 1) "*hedh në kompjuter*" 2) "*përpunoj në kompjuter*" 3) "*paraqes në kompjuter*".

Një rrugë e mirë, por dhe e vështirë për standardizimin e kësaj terminologjie është futja në përdorim e termave të përcaktuar e të mirëpërkufizuar, të cilët do të përdorreshin rrjedhshëm në të gjithë dokumentet e në të gjitha tekstet shkollore, profesionale e shkencore të vendit. Kjo bën të nevojshëm edhe hartimin e një fjalori të informatikës me përkufizime. Ky fjalor, nëpërmjet përkufizimeve përcakton kufijtë e termave të afërt, si ndërmjet *dosje* dhe *folder*, ashtu edhe mënjanon sinoniminë absolute, si ndërmjet *kompjuter* dhe *ordinator*⁵ etj.

⁵ Pasho, H. "Vështirësi mbi disa shfaqje të shumëkuptimësisë, të sinonimisë dhe të antonimisë në terminologjinë e ekonomisë në gjuhën shqipe" në "SF", 1986 / 3.